



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Nr. 3311/Prot.

Tiranë, më 05. 01.2025

VENDIM

Nr. 376, datë 19.12.2025

**“PËR KOMANDIMIN E MAGJISTRATES FATJONA MEMÇAJ SI PROKUROR
NDËRLIDHËS PRANË EUROJUST”**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, i përbërë nga:

1. Mirela BOGDANI	Kryetar
2. Erind GERMENJI	Zv/kryetar
3. Sokol STOJANI	Anëtar
4. Zeqir HODA	Anëtar
5. Arta MANDRO	Anëtar
6. Ledina RIZA	Anëtar
7. Moisi DUDA	Anëtar
8. Vatë STAKA	Anëtar
9. Olger EMINAJ	Anëtar
10. Erind MERKURI	Anëtar
11. Erion FEJZULLA	Anëtar

Në mbledhjen plenare të datës 19.12.2025, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenet 159-161, 164 dhe vijues të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar dhe në nenet 18 dhe vijues, të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Për komandimin e magjistrates Fatjona Memçaj si Prokuror ndërlidhës pranë Eurojust”

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Pasi mori në shqyrtim Relacionin shoqërues nr. 3311 prot., datë 17.12.2025, të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, dëgjoi Relatorin z. Sokol Stojani, si dhe referuar bazës ligjore të lartpërmendur, përfshirë diskutimet në mbledhje mbi çështjen,

V Ë R E N:

Bazuar në nenet 149, pika 1 dhe 149/a, pika 1, germa "e", të Kushtetutës, në nenet 53, pikat 1 dhe 2 si dhe 54, të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar, në nenet 164, pika 8, 166 dhe 189, pika 1, germa "a", të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" të ndryshuar, si dhe në nenet 4 dhe 5, të Ligjit nr. 113/2018, "Për ratifikimin e marrëveshjes për bashkëpunimin ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Eurojust-it", me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Komandimin e magjistrates Fatjona Memçaj, me detyrë Prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, si Prokuror ndërlidhës pranë Eurojust.
2. Afati i komandimit do të jetë 5 (pesë) vjet dhe fillon nga data 01.01.2026.
3. Të njoftohen për këtë vendim Prokurori i Përgjithshëm, Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe magjistratja Fatjona Memçaj.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

U shpall në Tiranë, sot më 19.12.2025.



KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

ZV/KRYETAR
Erind Germenji

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Zeqir Hoda

ANËTAR
Arta Mandro

ANËTAR
Ledina Riza

ANËTAR
Moisi Duda

ANËTAR
Vatë Staka

ANËTAR
Olger Eminaj

ANËTAR
Erind Merkuri

ANËTAR
Erion Fejzulla